



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK

| | |
|--|--------------|
| REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUB... | |
| Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo | |
| ARKIV ARHIV ARCHIVE | |
| Nr. i faq. Sh. str. | Data Data |
| Prot. no 143 | No page - 7 |
| PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA | |
| 21.03.2022 | |

**Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals**

RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E FUSHVEPRIMIT DHE

KOMPETENCAT E KOMISIONIT

PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE

Prishtinë, 2022

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 47 paragrafi 6 dhe Neni 20 paragrafit 1 të Statutit të OIK-ut,, në mbledhjen e datës 26.02.2022 miraton këtë:

RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E FUSHËVEPRIMIT DHE KOMPETENCAT E

KOMISIONIT

PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit për dhënien e mbështetjes financiare për anëtarët e OIK-ut dhe anëtarëve të familjes së ngushtë që kanë të drejtë në ndihmë financiare, ku përcaktohen burimi i mjeteve, qëllimi, shumat, kushtet dhe procedura për dhënien e ndihmës financiare.

Neni 2

Për dhënien e ndihmës sipas nenit 1 të kësaj Rregullore, Oda në pajtim me ligjin për odat e profesionistëve tjerë shëndetësorë dhe statutin e odës ndanë mjetet në fond të posaçëm.

Neni 3

Mjetet e Fondit sigurohen nga:

1. Kontributet vullnetare të anëtarëve të Odës dhe personave të tjerë juridik e fizik;
2. Gjohat e mbledhura nga masat disiplinore dhe taksat shtesë (dënime për mos përmbajtje të afateve të rilicencimit dhe të anëtarësimit) të shqiptuara;
3. Mjetet financiare sipas ndarjes buxhetore vjetore.

Komisioni për dhënien e ndihmës financiare

Neni 4

Komisioni për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare, që kujdeset për mbledhjen e fondeve dhe dhënien e ndihmës financiare ka pesë (5) anëtarë.

Anëtarët e Komisionit propozohen nga Këshilli Drejtues i Odës dhe votohen nga Kuvendi i Odës me mandat katër (4) vjeçar, në përputhje me mandatin e Kuvendit.

Neni 5

Mbikëqyrja e mjeteve të Fondit për Solidaritet bëhet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Këshilli Drejtues i Odës.

Mbështetja/dhënia e ndimës financiare

Neni 6

Kriteret për ndarjen e mjeteve nga Fondi i Solidaritetit

- ✓ Sëmundjet e antarëve të OIK-ut dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre;
- ✓ Fatkeqësitë e natyrave të ndryshme;
- ✓ Nevoja emergjente materiale;
- ✓ Nevoja të tjera shtesë.

Neni 7

1. Secili anëtar i Odës i cili rregullisht paguan anëtarësinë ka të drejtë në mbështetje/ndihmë financiare.
2. Anëtari i OIK-ut nuk mund të përfitojë më shumë se një herë në vit ndihmë financiare.

Neni 8

Mbështetja/ndihma financiare e njëhershme i takon anëtarit të Odës në rast të:

1. Shfaqja e sëmundjes së rëndë për shkak të së cilës nuk arrin t'i mbulojë kostot e shpenzimeve, të cilat nuk ofrohen nga institucionet publike shëndetësore, qoftë brenda apo jashtë vendit.
2. Sëmundja e një anëtari të OIK-ut dhe familjes së ngushtë të tyre.
3. Në rast të sëmundjeve të rënda të anëtarit të Odës, Oda do të mbulojë shpenzimet, në lartësinë prej 30 përqind nga shuma e mjeteve të participimit të anëtarit, në bazë të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë.
4. Anëtari i Odës duhet të faktojë me prova dhe dokumente relevante kërkesën për kompensim të shumës së mbetur të participimit.
5. Për ndihmën deri në vlerën 1000 euro vendos komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke me aprovimin e Kryetarit të Odës, ndërsa kërkesat për kompensim mbi shumën e lartëcekur me propozim të Komisionit, vendos Këshilli Drejtues.

Neni 9

1. Me daljen në pension të anëtarit të Odës, Oda do t'i ndajë shumën prej 200 euro.
2. Në rast të vdekjes së një anëtari të Odës, Oda do të mbështesë financiarisht familjen e tij të ngushtë me një shumë prej 200 euro.
3. Në rast të vdekjes në vend të punës ku vdekja është pasojë e aksidenteve të ndryshme ose sëmundjeve profesionale, Oda ndanë mjetet prej 500 Euro për familjen e tij të ngushtë.

Neni 10

Ndihma momentale

Në rastet kur anëtari i odës bie në situatë të rëndë financiare, pas argumentimit dhe justifikimit të njëjtit mund t'i ndahet ndihma në shumën maksimale 400 euro, duke pasqyruar gjendjen financiare (llogarinë bankare gjashtë mujore).

Neni 11

Fatkeqësitë natyrore dhe emergjenca të ndryshme

1. Në raste të fatkeqësive të ndryshme natyrore, emergjencave dhe gjendjet e jashtëzakonshme (vërshimet, djegiet, aksidentet e ndryshme, etj) komisioni do të vlerësoj secilin rastë veç e veç dhe në pajtim me mundësitë materiale të Fondit të Solidaritetit do të merr vendim/proponon për lartësinë e dëmshpërblimit.
2. Në të gjitha rastet kur lartësia e dëmshpërblimit nuk kalon shumën prej 1.000 euro vendos Komisioni me aprovim të Kryetarit.

Neni 12

1. Këshilli Drejtues me propozim të komisionit të Solidaritetit një pjesë të mjeteve mund ta dedikoj për organizimin e aktiviteteve sportive, kulturore për vizita brenda dhe jashtë Kosovës me qëllim të solidarizimit, bashkëpunimit dhe këmbimit të përvojave profesionale.
2. Për mbështetjen e punimeve të ndryshme shkencore dhe profesionale të anëtarëve të OIK (të prezantuara në emër të OIK).

Neni 13

1. Anëtari i Odës, i paraqet Komisionit një kërkesë me shkrim për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare.
2. Kërkesës i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës me të cilin vërtetohet baza për të kërkuar ndihmë (kopje të dokumenteve mjekësore me rekomandimet përkatëse, dhe dokumente tjera relevante).
3. Kërkesa për dhënien e ndihmës financiare dorëzohet në afat jo më larg se 60 ditë pas plotësimit të kushteve të përmendura në dispozitat e lartpërmendura të Rregullores.
4. Kërkesat emergjente duhet të vendosen nga komisioni në afat prej 7 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës ndërsa kërkesat e tjera në pajtim me rregullat e procedurës administrative.
5. Ndihma financiare paguhet në mënyrë të njehershme.
6. Në rast se kërkesa është jo e plotë, Komisioni do të kërkojë nga parashtruesi që të plotësojë të njëjtën brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.
7. Nëse parashtruesi nuk e dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, Komisioni do ta refuzojë kërkesën me vendim.

Neni 14

Komisioni vendos për kërkesat e paraqitura në mbledhjet e mbajtura sipas kësaj Rregullore.

Neni 15

Komisioni mund të parasheh edhe lehtësira fianciare për anëtarët e OIK-ut si:

1. Lirimi nga pagesa e taksave administrative të shërbimeve të OIK-ut për shkaqe të arsyeshme të cilat dëshmohen me dokumentacion përkatës të institucioneve përgjegjëse (gjendja e vështirë ekonomike familjare – dokumentet nga MPMS - QPS, dhe arsye tjera) të kërkuara nga Komisioni.

Neni 16

1. Komisioni merr vendim për kërkesën e paraqitur nga parashtruesi, anëtari i Odës.
2. Kundër vendimit të Komisionit, parashtruesi mund të paraqet ankesë në Këshillin Drejtues të Odës.
3. Ankesa parashtrohet brenda 15 ditëve pas pranimit të vendimit të Komisionit, Këshilli Drejtues i Odës është i detyruar të kthej përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga data e pranimit të ankesës.
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të Odës është i formës së prerë, dhe nuk mund të atakohet tutje me procedurën administrative

Neni 17

Komisioni është i detyruar të dorëzojë një raport mbi punën e tij në Këshillin Drejtues dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, dy (2) herë në vit apo çdo gjashtë (6) muaj.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 18

Kërkesat e parashtruara të cilat janë në procedurë shqyrtimi para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të shqyrtohen sipas rregullores paraprake.

Neni 19

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kryesuesi i Komisionit.

Neni 20

Ndeshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë miratimit.

Neni 21

Hartimi i formularëve bëhet nga Komisioni me Aprovimin e Këshillit Drejtues sipas rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 22

Çështjet tjera të cilat nuk janë të parapara në rregullore përcaktohen me propozim të Komisionit të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OIK-ut dhe nënshkrimit nga ana e kryetarit të OIK-ut.



Kryetari i OIK-ut

Naser Rrustemaj

Prishtinë, 2022